



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 14 prill 2023

Gjuha: Anglisht

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Selimit për Garanci Mbrojtëse në lidhje me Përgatitjen e Dëshmitarëve Identifikues

Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të Specializuar
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 79 dhe 116 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykues i informoi palët dhe pjesëmarrësit për lëshimin e një urdhri paraprak mbi zhvillimin e gjykimit ("Urdhri Paraprak") për të bërë parashtrime, nëse dëshironin, brenda 13 janarit 2023.¹
2. Më 22 dhjetor 2022, Trupi Gjykues shpërndau Urdhrin Paraprak për palët dhe pjesëmarrësit.²
3. Më 13 janar 2023, Trupi Gjykues mori parashtrime nga Mbrojtësi i Viktimave, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS"), parashtrime të përbashkëta me shkrim prej ekipeve të Mbrojtjes, dhe parashtrime të mëtejshme nga Mbrojtja e z. Krasniqi.³
4. Më 18 janar 2023, Trupi Gjykues mbajti konferencën përgatitore për gjykimin, gjatë së cilës, Mbrojtja e Z. Thaçi dhe Mbrojtësi i Viktimave bënë parashtrime të mëtejshme me gojë mbi Urdhrin Paraprak.⁴

¹ Transkripti i seancës, 16 dhjetor 2022, f. 1772-1773.

² F01178, Trupi Gjykues, *Urdhër për Parashtrime në lidhje me Urdhrin Paraprak mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 22 dhjetor 2022, me shtojcën 1.

³ F01202, Mbrojtësi i Viktimave, *Parashtrime të Mbrojtësit të Viktimave në lidhje me Urdhrin Paraprak mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 13 janar 2023; F01203, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime me Shkrim të Mbrojtjes së Përbashkët në lidhje me Urdhrin Paraprak mbi Zhvillimin e Gjykimit (F01178/A01)* ("Parashtrime të Mbrojtjes së Përbashkët"), 13 janar 2023; F01205, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Zhvillimin e Gjykimit*, 13 janar 2023; F01207, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime të Mëtejshme të Mbrojtjes së Krasniqit krahas Parashtrimeve me Shkrim të Mbrojtjes së Përbashkët mbi Zhvillimin e Gjyqit*, 13 janar 2023.

⁴ Transkripti i seancës, 18 janar 2023, f. 1893-1895, 1897-1901.

5. Më 25 janar 2023, Trupi Gjykses lëshoi urdhrin mbi zhvillimin e gjykimit ("Urdhri").⁵
6. Më 9 mars 2023, Mbrojtja e Rexhep Selimit ("Mbrojtja e Selimit") dorëzoi një kërkesë për garanci mbrojtëse në lidhje me përgatitjen e dëshmitarëve identifikues ("Kërkesa").⁶
7. Më 22 mars 2023, ZPS-ja iu përgjigj Kërkesës ("Përgjigjja").⁷
8. Mbrojtja e Selimit nuk ktheu kundërpërgjigje.

II. PARASHTRIME

9. Mbrojtja e Selimit i kërkon Trupit Gjykses të japë garanci mbrojtëse të mëtejshme në lidhje me përdorimin e fotografive dhe videove që mund të kenë lidhje me aspekte të identifikimit gjatë sesionit përgatitor.⁸ Ajo parashtron se të tilla garanci janë të nevojshme sepse: (i) dëshmitarët që japin dëshmi identifikuese janë veçanërisht të cenueshëm ndaj ndikimeve;⁹ dhe (ii) dëshmitë identifikuese përbëjnë një kategori të veçantë të dëshmimeve.¹⁰ Mbrojtja e Selimit argumenton se në Urdhër ka një boshllëk, meqenëse Urdhri nuk trajton problemin se çfarë materiale mund të përdoren me dëshmitarët gjatë sesioneve përgatitore para dhënies së dëshmisë.¹¹ Për të mbushur këtë boshllëk dhe për të mbrojtur paraqitjen e dëshmimeve identifikuese nga një komprometim i paqëllimshëm nga ZPS-ja,

⁵ F01226/A01, Trupi Gjykses, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 25 janar 2023.

⁶ F01360, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Selimit për Garanci Mbrojtëse në lidhje me Përgatitjen e Dëshmitarëve Identifikues*, 9 mars 2023.

⁷ F01390, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Selimit për Garanci Mbrojtëse në lidhje me Përgatitjen e Dëshmitarëve Identifikues*, 22 mars 2023.

⁸ Kërkesa, para. 1.

⁹ Kërkesa, para. 2.

¹⁰ Kërkesa, para. 11-34.

¹¹ Kërkesa, para. 3-4 që i referohet F01226/A01, Trupi Gjykses, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 25 janar 2023, para. 85-99.

Mbrojtja e Selimit i kërkon Trupit Gjykses të urdhërojë garancitë mbrojtëse të mëposhtme.¹²

- (i) pala thirrëse të njoftojë palën kundërshtare, jo më vonë se pesë ditë përpara përgatitjes së planifikuar të dëshmitarit, nëse synon të përdorë ndonjë material për identifikim (që përfshin, ndër të tjera, identifikimin e uniformave, fytyrave dhe zërave);
- (ii) pala kundërshtare të kundërshtojë përdorimin e materialeve të tillave jo më vonë se tri ditë para një takimi të planifikuar përgatitor me dëshmitarët;
- (iii) në rast se një dëshmitari i tregohen për herë të parë imazhe që të verifikohet nëse mund të identifikojë individë konkretë, pala thirrëse ta incizojë me video dhe ta bëjë të njohur këtë aspekt të sesionit përgatitor;
- (iv) pala thirrëse të regjistrojë të gjitha provat e përdorura gjatë sesioneve përgatitore të dëshmitarëve, duke shënuar rendin në të cilin janë përdorur, nëse fotografitë janë treguar njëra pas tjetrës apo njëkohësisht, vulat specifike kohore për videot dhe nëse janë shfaqur me apo pa zë; dhe
- (v) çdo formë përgatitjeje e dëshmitarëve të shtyhet deri në vendimin e Trupit Gjykses mbi Kërkesën (bashkërisht, “garancitë mbrojtëse të kërkuara”).¹³

10. Mbrojtja e Selimit parashtron se lëshimi i udhëzimeve shtesë nuk përbën rishikim të Urdhrit.¹⁴ Së fundi, Mbrojtja e Selimit i kërkon Trupit Gjykses të urdhërojë ZPS-në: (i) që të paraqesë menjëherë garancitë mbrojtëse të kërkuara në lidhje me përgatitjen e cilitdo dëshmitar të ZPS-së dëshmia e të cilëve synon të

¹² Kërkesa, para. 7.

¹³ Kërkesa, para. 6, 37-38.

¹⁴ Kërkesa, para. 8-10.

identifikojë ose të akuzuarin, ose pjesëtarë të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, dhe instrumente që përmenden në paragrafin 35 të Aktakuzës (“dëshmitarët identifikues”), ose individualisht ose në grup; ose (ii) të pezullojë përgatitjen e dëshmitarëve identifikues të mundshëm derisa kjo Kërkesë të gjejë zgjidhje.¹⁵

11. ZPS-ja parashtron se kjo kërkesë duhet hedhur poshtë.¹⁶ Ajo argumenton se Kërkesa është jashtë afateve, pasi Mbrojtja e Selimit as nuk ka paraqitur në Kërkesë parashtrime lidhur me Urdhrin Paraparak, as nuk e ka apeluar Urdhrin.¹⁷ Ajo argumenton se Kërkesa synon rishikim të Urdhrit, por që nuk e plotëson standardin për rishikimet sipas rregullës 79.¹⁸ Ajo pretendon se në secilin nga burimet e cituara nga Mbrojtja e Selimit trajtohen aspekte konkrete të ngritura gjatë gjykimit, ndryshe nga Kërkesa, e cila synon rishikimin e Urdhrit disa javë pas lëshimit të tij.¹⁹ ZPS-ja më tej parashtron se Kërkesa është e pabazuar.²⁰ Ajo argumenton gjithashtu që Urdhri përmban garanci mbrojtëse të mjaftueshme për shqetësimet e ngritura në Kërkesë.²¹ Së fundi, ZPS-ja pretendon se garancitë mbrojtëse të kërkuara janë të papërshtatshme.²²

III. DISKUTIM

12. Trupi Gjykses mendon se Mbrojtja e Selimit ka pasur mundësi të bollshme që të shprehte shqetësimet e ngritura në Kërkesë përpara se Trupi Gjykses të nxirrte Urdhrin. Mbrojtja e Selimit mund ta kishte paraqitur përmbajtjen e kësaj Kërkesë brenda 13 janarit 2023, qoftë si pjesë e parashtrimeve të përbashkëta të paraqitura

¹⁵ Kërkesa, para. 35.

¹⁶ Përgjigjja, para. 24.

¹⁷ Përgjigjja, para. 1, 3-5

¹⁸ Përgjigjja, para. 1, 6-9.

¹⁹ Përgjigjja, para. 9.

²⁰ Përgjigjja, para. 10-16.

²¹ Përgjigjja, para. 2, 17-21.

²² Përgjigjja, para. 22-23.

nga Mbrojtja,²³ qoftë si pjesë parashtrimesh individuale.²⁴ Mbrojtja e Selimit mund të bënte edhe parashtrime me gojë gjatë konferencës përgatitore për gjykimin. Gjithashtu, në rast se do e konsideronte Urdhrin të papërshtatshëm, Mbrojtja e Selimit mund të kishte kërkuar leje për ta apeluar Urdhrin pas lëshimit të tij nga Trupi Gjykses.²⁵ Mbrojtja e Selimit nuk ka dhënë arsye për mosparaqitjen e shqetësimeve mbi procesin e identifikimit në asnjërën nga këto faza. Për sa i përket synimit të saj për rishikimin e Urdhrit, Mbrojtja e Selimit nuk ka arritur të vërtetojë se janë përmbushur kriteret për rishikim sipas rregullës 79.

13. Megjithëse për qëllimet e tanishme nuk ka qenë faktor vendimtar, Trupi Gjykses rikujton pohimin e ZPS-së se Mbrojtja e Selimit nuk i ka kërkuar ende që t'i diskutojnë mes tyre shqetësimet që ka ngritur në Kërkesë.²⁶ Trupi Gjykses kujton se në përgjithësi pritet që palët dhe pjesëmarrësit të diskutojnë mes tyre për të gjetur zgjidhje të pranueshme, dhe t'i drejtohen Trupit Gjykses vetëm kur kjo gjë nuk është e mundur.²⁷

14. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se Kërkesa bazohet në argumentet se: (i) dëshmitarët identifikues janë shumë të cenueshëm; dhe se (ii) pa garancitë mbrojtëse të kërkuara, këta dëshmitarë në mënyrë të paqëllimshme mund të komprometohen gjatë sesioneve përgatitore.²⁸ Trupi Gjykses vëren se në Kërkesë, Mbrojtja e Selimit nuk identifikon ndonjë dëshmitar apo dëshmitarë konkretë tek të cilët problemet e identifikimit gjatë sesioneve të përgatitjes së dëshmitarëve të përbëjnë shqetësim që të kërkojë ndërhyrjen e Trupit Gjykses që në këtë fazë. Rrjedhimisht, kërkesa është hipotetike dhe, në rastin më të mirë, e parakohshme. Në rast se në lidhje me dëshmitarë konkretë do të materializohet ndonjë nga

²³ *Shih* Parashtrime të Përbashkëta të Mbrojtjes lidhur me Urdhrin Paraparak.

²⁴ *Shih p.sh.* F01207, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime të Mëtejshme të Mbrojtjes së Krasniqit krahas Parashtrimeve të Përbashkëta me Shkrim të Mbrojtjes mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 13 janar 2023.

²⁵ *Shih p.sh.* F01246, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Krasniqit për Leje për Apelimin e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 1 shkurt 2023.

²⁶ Përgjigjja, para. 23.

²⁷ Urdhri, para. 7.

²⁸ Kërkesa, para. 5, 7, 37.

shqetësimet për të cilat është bërë Kërkesa, Mbrojtja e Selimit– ose çdo palë tjetër me shqetësime të ngjashme në të ardhmen – mund ta ngrenë si problem me ZPS-në, dhe në rast se nuk arrijnë të gjejnë zgjidhje të pranueshme mes tyre, të kërkojnë mjetin e duhur juridik nga Trupi Gjykses.²⁹

IV. VENDIM

15. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses E RRËZON Kërkesën.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 14 prill 2023

Hagë, Holandë.

²⁹ *Shih gjithashtu F01300, Trupi Gjykses, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Krasniqit për Leje për Apelimin e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit, 16 shkurt 2023, para. 23.*